



Të nderuar,

Është kënaqësi e veçantë të jem pjesë e kësaj ceremonie që shënon një hap tjetër të kontributit shumë të rëndësishëm që KFW në vazhdimësi ka dhënë për zhvillimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore ka arritur të shndërrohet në një institucion shumë të rëndësishëm për rritjen dhe lehtësimin e financimit për ekonominë e vendit. Roli i rëndësishëm i këtij institucion është shpërfaqur sidomos gjatë periudhës së krizës pandemike, me ç'rast ky institucion ka shërbyer si një mekanizëm shumë efektiv i transmetimit dhe multiplikimit të ndihmës shtetërore për sektorin privat të vendit.

Granti që po dhurohet nga KFW do të mundësojë rritjen e mëtejme të potencialit garantues të këtij institucioni, duke bërë të mundur rritjen e numrit të përfituesve nga garancionet që lëshon ky institucion. Me fjalë të tjera, një numër më i madh i individëve apo bizneseve me vështirësi të qasjes në financim kreditor, do të mund të sigurojnë qasje me kushte lehtësuese në këtë burim financimi.

Kreditimi bankar vazhdon të jetë një burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit të sektorit privat në Kosovë. Vlera e kredive bankare deri në shtator 2021 ka arritur në 3.57 miliardë euro, duke shënuar një rritje të

konsiderueshme vjetore prej 12.2%. Sidoqoftë, me gjithë trendin e kënaqshëm të rritjes së kreditimit bankar, konsiderohet se shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë vazhdon të jetë nën mesataren e vendeve të rajonit, gjë që tregon se, në raport me madhësinë e ekonomisë, ekziston hapësirë e mëtejme për zgjerim të aktivitetit kredidhënës.

Rol të rëndësishëm në plotësimin e kësaj hapësire ka pikërisht Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili përmes mekanizmit të tij garantues mund të mundësojë rritjen e kreditimit dhe lehtësimin e kushteve të qasjes në kredi për sektorët të cilët pa këtë shërbim mund ta kenë të vështirë apo edhe të pamundur të sigurojnë qasje në financim kreditor. Në këtë kontekst, ne presim që përveç mbështetjes së rritjes së financimit kreditor në përgjithësi, portofoli i FKGK-së çdo ditë e më tepër të reflektojë rritjen e mbështetjes kreditore për sektorët me vështirësi më të madhe të qasjes në financim kreditor, por të cilët kanë potencial për të dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Për fund më lejoni që edhe një herë të shpreh vlerësimin tim më të lartë për KFW-në, e cila në vazhdimësi është dëshmuar si mbështetëse shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës.